



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.11.2018, ora 15:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 10929, datë 05.11.2018 për propozimin e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj dhe Reme Lala.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Anastas Angjeli, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Vitore Tusha – kandidate për kryetare e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Bledar Dervishaj – Këshilltar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut nga institucioni i Presidentit të Republikës

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe - Mirëmbërëma të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Siç jeni njoftuar, një nga çështjet e sotme në rendin e ditës ka qenë edhe shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 10929, datë 05.11.2018 për propozimin e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, për shkak të vakancës së krijuar në krye të këtij institucioni në përfundim të mandatit të kryetarit aktual të KLSH-së, zotit Bujar Leskaj.

Dekreti i Presidentit ka mbërritur në Kuvend që në datën 9 nëntor, është bërë hyrja në Kuvend po në këtë datë dhe natyrisht është programuar nga ana e Konferencës së Kryetarëve për t'u marrë në shqyrtim nga komisioni përgjegjës, që është komisioni ynë.

Referuar ligjit “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” do të doja t'ju bëja me dije se në nenin 19: “Zgjedhja dhe qëndrimi në detyrë”, KLSH-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga kryetari i KLSH-së. Kryetari i KLSH-së zgjidhet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës për një mandat 7-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje”.

Në nenin 20, ku përcaktohen kushtet për t'u zgjedhur kryetar i KLSH-së, thuhet: “Kryetar i KLSH-së duhet të zgjidhet shtetasi shqiptar që plotëson kushtet e mëposhtme: ka arsim të lartë në ekonomi, financë ose drejtësi, ka përvojë profesionale në çështjet financiare, ka kualifikime të larta profesionale dhe përvojë pune në profesion, jo më pak se 10 vjet, gëzon integritet moral dhe profesional. Nuk është dënuar më parë për kryerjen e një krimi gjyqësor të formës së prerë”.

Në nenin 21 “Papajtueshmëritë e funksionit”, përcaktohet qartë: “Kryetari i KLSH-së, gjatë ushtrimit të funksionit të tij nuk mund të jetë anëtar i Kuvendit, anëtar i Këshillit të Ministrave, i zgjedhur në organet e pushtetit vendor apo në organet e ndonjë partie politike ose organizate politike. Ai nuk mund të kryejë detyra me ose pa shpërblim në subjekte të tjera publike, private apo jofitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies, botimeve, veprimtarive kulturore dhe sportive, me kusht që këto aktivitete nuk dëmtojnë dinjitetin e institucionit dhe nuk cenojnë paanshmërinë dhe pavarësinë e tij. Kryetari i KLSH-së fillon detyrën pasi bën betimin para Kuvendit”.

Në nenin 22 “Imuniteti”. “Kryetari i KLSH-së ka imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Kryetari i KLSH-së gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra

në ushtrimin e funksioneve të tij. Kryetari i KLSH-së nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria në çfarëdo forme, apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal apo banese pa autorizimin e Gjykatës Kushtetuese, përveçse nëse kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi. Në këtë rast Prokurori i Përgjithshëm vë menjëherë në dijeni Gjykatën Kushtetuese, e cila nëse nuk jep pëlqim brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë”.

“Mbarimi i mandatit dhe shkarkimi”.

“Mandati i kryetarit të KLSH-së mbaron kur: mbaron afati 7-vjeçar i qëndrimit në detyrë; dënohet nga gjykata me një vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi; nuk paraqitet në detyrë për shkaqe të paarsyeshme; jep dorëheqjen; deklarohet i paaftë për të vepruar me vendim gjykate të formës së prerë; mbush moshën e pensionit” e të tjerë.

Këto janë nenet që përcaktojnë, ngarkojnë me detyrë, Presidentin e Republikës, Kuvendin dhe pastaj përcaktojnë edhe kriteret mbi bazën e të cilave një kandidaturë është e mundshme për të qenë kryetar i KLSH-së.

Jua bëra me dije në mënyrë që gjithsecili nga anëtarët e komisionit të jetë i qartë në këtë aspekt. Pas kësaj do të kalojmë menjëherë në prezantimin e kandidatit të propozuar nga ana e Presidentit të Republikës, zonjës Vitore Tusha.

E nderuar zonjë, dëshirojmë një prezantim tuajin personal dhe profesional. Nga ana tjetër edhe një vizion tuajin lidhur me atë që ju mendoni për drejtimin e KLSH-së.

Pastaj nëse ndonjë nga kolegët do të ketë interes të bëjë pyetje lidhur me atë që do të prezantoni, jeni të lutur të adresoni pyetjet dhe ju do të jeni e lutur të ktheni disa përgjigje ashtu si e mendoni.

Fjala është për ju.

Faleminderit!

Vitore Tusha – I nderuar zoti kryetar i Komisionit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Para së gjithave e konsideroj vlerësim dhe përgjegjësi të madhe faktin që Presidenti i Republikës më ka propozuar për të drejtuar KLSH-në, një institucion shumë i rëndësishëm me impakt, me ndikime kushtetuese, me ndikim të lartë në mirëqeverisjen e vendit, në veçanti në efikasitetin e përdorimit të burimeve publike rreth kontributit të taksapaguesve.

Besimin që më ka dhënë Kuvendi i Shqipërisë duke më votuar disa herë në funksione të larta kushtetuese, vazhdimisht e kam vlerësuar me përgjegjshmëri të lartë si një detyrim për të shërbyer në forcimin e shtetit ligjor, veçanërisht në mbrojtje të të drejtave

themelore të shtetasve. Mbi të njëjtat parime dhe me shumë respekt ju drejtohem ju të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë që të më jepni përsëri besimin duke më votuar për pozicionin e kryetarit të KLSH-së.

Përvoja më se 35 - vjeçare në fushën e së drejtës që përfshin edhe çështje të natyrës financiare, e fituar nga detyrat dhe nga angazhimet që kam kryer, me kanë dhënë mundësinë jo vetëm të njoh dhe të zbatoj ligjin, por të marr vendime bazuar në legjislacionin që lidhet me taksat, tatimet, prokurimet publike, Kodin Doganor, buxhetin, koncesionet, me tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme publike, me shoqëritë tregtare, atë të falimentit e të tjera ligje që rregullojnë marrëdhënie, veprimtari ekonomike dhe financiare në vend, mbi të cilat kontrollohet ligjshmëria e veprimtarisë së subjekteve publike apo personave juridikë me aksione të shtetit mbi 50% dhe kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.

Po ashtu ushtrimi i detyrës të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese ndër të tjera më ka dhënë mundësinë që të jem pjesë e vendimmarrjes për përcaktimin e drejtimeve kryesore të shpenzimeve të mjeteve buxhetore të Gjykatës Kushtetuese, si edhe në vlerësimin e raportit të këtyre shpenzimeve çdo 6 muaj si një nga kompetencat e posaçme të mbledhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Më lejoni që të paraqes shkurtimisht para jush këndvështrimin tim lidhur me drejtimin e institucionit të KLSH-së dhe besimin se kjo do t'i kontribuojë vendimmarrjes suaj për miratimin e kandidaturës sime në këtë pozicion.

Paraprakisht më duhet të theksoj se idetë që do të parashtroj janë rrjedhojë e një këndvështrimi të jashtëm të institucionit, por që do të zhvillohet dhe do të thellohet më tej me ekspertë të fushës, me stafin e KLSH-së dhe në bashkëpunim me ju. Ato do të udhëheqin filozofinë time të menaxhimit të këtij institucioni dhe në të njëjtën kohë do të bëhen pjesë e planit strategjik dhe vjetor të institucionit.

Nuk është e tepër të theksoj që në krye të herës dhe të garantoj Kuvendin se në themel të punës sime do të jetë kurdoherë vetëm Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, kuadri ligjor rregullues për KLSH-në dhe standardet, praktikat më të mira ndërkombëtare të auditimit. Përvoja disavjeçare e krijuar nga puna e stafit dhe e drejtuesve të KLSH-së ndër vite, do të jetë për mua dhe stafin një burim i rëndësishëm për menaxhimin e këtij institucion me synimin për ta çuar më përpara punën e tij dhe për ta përafruar atë me përvojat më të mira ndërkombëtare.

Në këtë kuadër këndvështrimi im do të fokusohet në përditësimin e misionit të KLSH-së për të ndikuar dhe për të nxitur përgjegjshmërinë e organeve qeveritare në të gjitha nivelet për menaxhimin efikas të burimeve publike. Kjo presupozon se procesi i auditimit të KLSH-së do të fokusohet në shqyrtimin e përgjegjësisë së menaxherëve publikë për përdorimin e burimeve publike në përputhje me legjislacionin nga njëra anë, por edhe për performancën e përdorimit të burimeve publike nga ana tjetër, që nënkupton vlerësimin nga ana e KLSH-së të përdorimit të këtyre burimeve me kursim, dobi dhe frytshmëri.

Për të bërë të mundur realizimin e këtij misioni KLSH-ja nën drejtimin tim do të prezantohet përpara Kuvendit të Shqipërisë dhe qytetarëve si një trupë audituese profesionale ekspertësh, duke u larguar gjithnjë dhe më shumë nga një qasje represive dhe si një këshilltar i një niveli të lartë të Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve publike. Filozofia ime në menaxhimin e këtij institucioni lidhet me demokratizimin e funksioneve të kryetarit të KLSH-së në procesin e planifikimit dhe të vendimmarrjes. Kjo nënkupton delegimin e disa kompetencave të stafi, duke ruajtur kurdoherë përgjegjësinë time si kryetare për të gjithë procesin. Në kushtet aktuale kjo do të realizohet duke tërhequr mendimin e stafit të nivelit të lartë dhe të ekspertëve me synimin për ta finalizuar më tej këtë proces, me ndryshimin e formave të organizimit dhe të drejtimit të KLSH-së në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Institucioni i KLSH-së kompetent për të ushtruar kontrollin ekonomik dhe financiar është krijuar nga Kushtetuta, si një nga mekanizmat garant që pushteti shtetëror të ushtrojë në interesin e përbashkët të të gjithë qytetarëve. Për këtë qëllim, Kushtetuta, duke e theksuar pavarësinë e këtij organi në ushtrimin e veprimtarisë, njëkohësisht e ka vendosur në raporte të caktuara me vetë organet kushtetuese, si dhe me organet e tjera qendrore të pushtetit shtetëror veçanërisht me Kuvendin e Shqipërisë.

Komunikimi i institucioneve midis kompetencave kushtetuese dhe ligjore shërben si mjet me anë të të cilit realizohet, vihet në jetë ushtrimi i plotë i kompetencave të ndërlidhura të institucioneve respektive, që në rastin konkret sjell efekt në rolin e Kuvendit për mbikëqyrjen e KLSH-së. Në këtë kuptim komunikimi me Kuvendin e Shqipërisë mbetet gjithnjë i një rëndësie të veçantë kushtetuese, prandaj për ta sanksionuar dhe për ta konsoliduar më tej këtë bashkëveprim vlerësoj se duhet të ndërmerren disa masa që konsistojnë në rritje e prezencës së KLSH-së në Kuvendin e Shqipërisë nëpërmjet pjesëmarrjes së vazhdueshme në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave, me qëllim që

problemet e shtruara aty të mund të bëhen objekt i punës së KLSH-së, duke ruajtur pavarësinë dhe paanshmërinë.

Në ushtrimin e kompetencës ligjore do t'i kërkoj Kuvendit të Shqipërisë që të dëgjohet në seanca të veçanta për çështje që institucioni i çmon të rëndësishme në realizimin e misionit të tij dhe në këtë funksion do të propozoj projektrezoluta të posaçme, në informimin e vazhdueshëm periodik të Komisionit të Ekonomisë për çështje të rëndësishme që kanë dalë nga auditimet e kryera dhe nga zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së në ngritjen e një njësie të posaçme brenda strukturës organizative për të ndjekur marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë dhe në përmirësimin e strukturës, raporteve të paraqitura në Kuvend, duke thjeshtuar përmbajtjen dhe duke përshtatur gjuhën e tyre, në mënyrë që mesazhi të përcillet sa më saktë.

Rishikimi i kuadrit ligjor dhe rregullator me qëllim garantimin e misionit dhe realizimin e objektivave është një tjetër çështje që do të jetë objekt i punës sime, që do të fokusohet në finalizimin e ndryshimeve ligjore të nisura nga kreu aktual i KLSH-së me synimin për të përsosur format e organizimit dhe drejtimit në të gjitha procedurat e auditimit, në sanksionimin në ligj të formave kolegjiale për drejtimin e KLSH-së në përshtatje me praktikën më të përparuar të vendeve europiane, në rritjen e pavarësisë së audituesit në procesin e planifikimit, ekzaminimit dhe të formulimit të opinionëve të auditimit jashtë çdo ndikimi të jashtëm në forcimin e përgjegjësisë së audituesve në lidhje me cilësinë e raporteve, opinionëve dhe rekomandimeve të auditimit, në garantimin e profesionalizmit të audituesve nëpërmjet certifikimit profesional të tyre si një parakusht për të siguruar cilësinë dhe procesin e auditimit.

KLSH-ja në vetvete nuk bën pjesë në strukturat e mirëfillta antikorruption, megjithatë ka ndikim dhe rol shumë të rëndësishëm në luftën ndaj korrupsionit dhe paligjshmërisë në fushën e përdorimit të burimeve publike, në dokumentet e institucioneve ndërkombëtare të auditimit, si INTOSAI.

E theksoj me forcë rritjen e rolit të KLSH-së në këtë fushë dhe forcimin e kapaciteteve të auditimit, për faktin se ky fenomen ka ende një përhapje të gjerë dhe vendi ynë është angazhuar në luftën e vazhdueshme kundër korrupsionit, duke e parë edhe në përmbushjen e një prej kriterëve vlerësues për çeljen e negociatave me BE-në. Institucioni i KLSH-së do të vazhdojë të kontribuojë në këtë drejtim, duke përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme metodat audituese duke u mbështetur në standardet e auditimit dhe në praktikën më të mira botërore, si edhe duke rritur kapacitetet profesionale të tij.

Në praktikën aktuale, me sa jam e informuar ka një diferencë të ndjeshme ndërmjet rasteve të referuara në prokurori nga KLSH-ja dhe numrit të çështjeve penale të filluara dhe të dërguara për gjykim. Faktorët që kanë sjellë këtë gjendje mund të jenë të shumtë, lidhen si me punën e prokurorisë, ashtu edhe me atë të KLSH-së. Në këtë drejtim pa dashur të bëj analizën e të gjithë faktorëve që kanë sjellë këtë gjendje, do të vlerësoja disa nga ata, që lidhen me punën e KLSH-së, përmirësimi i të cilave do të ngushtojë këtë diferencë, si: niveli i kualifikimeve në fushën e kuptimit të veprave penale, cilësia e kallëzimeve me përshkrim të saktë krahas rrethanave faktike dhe cilësimin ligjor të elementeve të veprave penale të dyshuara dhe paraqitja e provave të nevojshme.

Në lidhje me rolin e KLSH-së në luftën ndaj korrupsionit dhe paligjshmërisë, auditimet dhe puna e institucionit do të orientohen në shumë drejtime si: vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin që presupozon shqyrtimin e procedurave dhe kuadrit rregullator të sektorit publik, me qëllim që procedurat dhe sistemet të minimizojnë mundësinë e abuzimeve dhe shpërdorimit të burimeve publike.

Shitmi i vëmendjes në planifikimin dhe kryerjen e auditimeve në fushat me ekspozim të lartë të riskut, si ato të prokurimeve publike, tjetërsimit të pronave publike, ndërtimeve e të tjera, shkëmbimit të informacionit me organet e tjera të zbatimit të ligjit dhe vendosjes së bashkëpunimit të vazhdueshëm me to, trajnimit të stafit lidhur me kuptimin, evoluimin e legjislacionit penal dhe të gjithë legjislacionit në të cilin bazohet veprimtaria e subjektit që auditohet, vendosjes së marrëdhënieve bashkëpunuese me prokurorinë, si dhe me institucionet e reja të drejtësisë si: SPAK-u dhe Byroja e Hetimit gjatë gjithë fazave të hetimit në lidhje me çështjet e referuara nga KLSH-ja.

Përmirësimi i procesit të raportimit është një nga drejtimit që nga këndvështrimi im do të jetë prioritar. Shkrimi i raporteve profesionale të auditimit është me rëndësi për të gjithë procesin e auditimit, sipas parimit se “raportet e auditimit shkruhen për lexuesit”, pasi “qytetarët janë përfituesit kryesorët të auditimit publik”. Duke qenë se për këto raporte janë të interesuar një numër i gjerë lexuesish dhe përdoruesit e tyre janë të shumtë, duke filluar siç e thashë më lart nga qytetarët, menaxherë publikë të niveleve të ndryshme e të tjerë do të duhet që gjuha e tyre të jetë e qartë dhe e kuptueshme për të gjitha kategoritë e mësipërme, në mënyrë që ato të kuptojnë realisht përmbajtjen e tyre. Kjo do të sigurojë pjesëmarrjen e palëve të mësipërme në procesin e auditimit dhe të zbatimit të rekomandimeve, si dhe do të rrisë efektivitetin e vetë procesit të auditimit. Në këtë drejtim

do të synojmë uljen e volumit të raporteve dhe përqendrimin e tyre në pasqyrimin e gjetjeve kryesore, formulimin e raporteve me gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për të gjithë përdoruesit, formulimin e rekomandimeve profesionale që synojnë përmirësimin e sistemeve dhe procedurave, përkundrejt atyre që kanë të bëjnë me zbatimin e procedurave ekzistuese rutinë; ndjekjen e rekomandimeve në mënyrë periodike dhe vendosjen e sistemit të kontrollit të zbatimit të tyre, publikimin e raporteve të plota në faqen zyrtare dhe administrimin e reagimeve të përdoruesve të raportit sipas kriterëve të raportit të INTOSAI-t Londër të vitit 2016.

Aktualisht mbetet problem rikuperimi i dëmeve të konstatuara nga KLSH-ja. Sipas pikëpamjes sime, kjo vjen edhe për shkak se nuk ka kritere të përcaktuara qartë nga ana administrative për konceptin e dëmit të raportuar, kualifikim të mjaftueshëm të stafit lidhur me kuptimin dhe përmbajtjen e dëmit, si dhe kuadër ligjor lidhur me përgjegjësinë materiale të zyrtarëve publikë.

Në këtë drejtim vëmendja do të përqendrohet në:

Rikualifikimin e konceptit të dëmit të raportuar nga KLSH-ja, referuar legjislacionit administrativ, civil, si dhe doktrinëve përkatëse, nxjerrjen e udhëzimeve analitike në lidhje me zbatimin e këtij koncepti në raportim.

Vendosjen e një sistemi raportimi të detyrueshëm në lidhje me arkëtimin e dëmeve të shkaktuara dhe të vendosura për zhdëmtim.

Rivendosjen e institutit të përgjegjësisë materiale të punonjësve publikë nëpërmjet propozimit të një ligji të veçantë.

Rritja e nivelit profesional të auditimit është theksuar me forcë dhe në deklaratën e Abu Dhabit, e miratuar në kongresin e XXII të INTOSAI-t në dhjetor 2016, sipas së cilës: “Institucionet supreme të auditimit duhet të performojnë me auditime cilësore dhe t’u ofrojnë qytetarëve raporte që mbështesin transparencën, përgjegjshmërinë dhe besimin në qeverisje”.

Për këtë qëllim KLSH-ja duhet të avancojë në ambiciet profesionale për të arritur një nivel të lartë pavarësie, ekspertize, kompetence dhe sjelljeje etike. Situata korrente kërkon një përmirësim të profesionalizmit të auditëve, pasi vetëm auditët e institucionit të lartë të Kontrollit të Shtetit, të cilët presupozohet të kenë nivelin më të lartë të ekspertizës, nuk janë të certifikuar. Për analogji mjafton të përmendim faktin se punësimi në sektorin e auditimit të brendshëm publik ka si parakusht certifikimin e tyre, po kështu profesioni i lirë i ekspertit

kontabël të autorizuar apo madje edhe i kontabilistëve kërkon një proces licencimi, ku kandidatët duhet të kalojnë me sukses disa provime.

Lidhur me këtë do të duhet që fillimisht, por edhe në vazhdimësi të ndërmerren disa hapa, të cilët konsistojnë:

Në rritjen e kapacitetit të auditimit në përgjithësi, duke shqyrtuar me kujdes vendosjen e raporteve të drejta dhe të studiuara midis llojeve të ndryshme të auditimit, si auditimi financiar, i pajtueshmërisë, performancës e të tjerë, si dhe futjen e formave të reja të auditimit, si ai i integritetit dhe etikës, por edhe kombinimi midis tyre.

Në rishikimin e vazhdueshëm të metodologjive të auditimit, me qëllim përshtatjen me praktikën më të mira dhe trajnimin e auditëve për implementimin e tyre nëpërmjet mbështetjes së donatorëve në paraqitjen e projekteve për financim.

Në një plan intensiv të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të auditëve me kurrikula të hartuara me ekspertë të huaj të certifikuar.

Në vendosjen e kriterëve parakualifikuesë me kërkesa të larta profesionale për pranimet e reja në KLSH.

Në hartimin e një skeme edukimi që do të finalizohet me certifikimin e auditëve sipas kategorive.

Në adoptimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, duke i dhënë prioritet dhe duke forcuar rolin e grupeve me atributet e një autoriteti profesional, që do të japë gjykime periodike mbi cilësinë e auditimeve. Në vendosjen e sistemit të shpërblimit vjetor, bazuar në cilësinë e auditimeve të kompletuara.

Auditimi i brendshëm shpeshherë konsiderohet si “krahu i zgjatur” i institucioneve supreme të auditimit. Vendosja e bashkëpunimit me këtë strukturë, përtej çdo hierarkie, do të shumëfishonte kapacitetin e KLSH-së. Bashkëpunimi me auditimin e brendshëm, por jo vetëm, duke përfshirë këtu edhe shoqatat profesionale të kontabilistëve, ekspertët kontabël të autorizuar, shoqërinë civile e të tjerë, do të konsiderohet nga ana ime në praktikën e drejtimit të KLSH-së, si një fuqi komplementare, që do t’i kontribuojë menaxhimit të shëndoshë të financave publike.

Nga ana tjetër, jam tërësisht e prirur për të vazhduar dhe thelluar edhe më tej bashkëpunimin me institucionet homologe të auditimit dhe strukturat përkatëse në Komisionin Europian, për të përfituar reciprokisht nga përvojat, sipas motos së INTOSAI-t: “Nga eksperiencia e përbashkët përfitojnë të gjithë!”.

Për këtë qëllim:

Shkëmbimi i planeve vjetore të auditimit do të jetë praktikë e përhershme midis institucioneve, bazuar kjo edhe në marrëveshjet e lidhura më parë, të cilat mund të rishikohen sipas këndvështrimeve të reja.

Do të shmangim tërësisht mbivendosjet midis strukturave të KLSH-së dhe të Auditimit të Brendshëm, duke përdorur punën e këtij të fundit sipas standardeve ndërkombëtare, me qëllim shmangien e kostove administrative.

Mbështetja nga ana e KLSH-së e punës së audituesve të brendshëm pranë niveleve të larta të menaxhimit e deri në qeveri për të siguruar pavarësinë e tyre profesionale dhe zhvilluar profesionalizmin.

Trajnime të përbashkëta dhe tryeza profesionale për çështje të rëndësishme të auditimit, metodave e teknikave, qasjeve të tij, do të vazhdojnë të zhvillohen edhe në të ardhmen.

Aktivizimi i ekspertëve të fushave të ndryshme dhe për probleme të veçanta, me qëllim rritjen e kapacitetit të auditimit dhe nivelit të ekspertizës.

Si përfundim, me lejon t'ju siguroj se angazhimi im profesional, përvoja e deritanishme dhe përkushtimi që më karakterizon në përmbushjen e detyrave do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Ju faleminderit për vëmendjen që më kushtuat!

Erion Braçe – Shumë faleminderit, zonjë për prezantimin tuaj, jo vetëm profesional, personal të konsumuar në harkun e gjithë këtyre viteve shërbim publik kundrejt institucioneve kushtetuese në këtë vend, por edhe për vizionin tuaj në drejtimin e KLSH-së!

A ka ndonjë pyetje për zonjën nga ana e kolegëve deputetë rreth asaj që u prezantua këtu? Nuk ka.

Shumë faleminderit, e nderuar zonjë për prezencën, për prezantimin tuaj dhe për mendimet që ndatë me këtë komision! Komisioni do të ketë kohën e tij për të hartuar raportin për seancën plenare lidhur me dekretin e Presidentit dhe kandidaturën tuaj!

Shumë faleminderit! Jeni e lirë të largoheni.

Vitore Tusha - Faleminderit!

Erion Braçe –Komisioni qëndron i mbledhur, ndërkohë që do t'u luteshim gazetarëve të lirojnë pak sallën.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti